

VENDIM
Nr.558, datë 11.8.2011

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1135, DATË 5.8.2008 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË
SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr.10 405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” të nenit 88 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.1135, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa e ndryshime:

a) Lidhja nr.1 “Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Policisë së Shtetit”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Pas pikës 5/3 shtohet pika 5/4 me këtë përmbajtje:

“5/4 Punonjësit e policisë të cilët punojnë në strukturat e policisë shkencore, në zyrën e përgjimeve, në strukturat kundër antieksplzivëve dhe lëndëve të tjera plasëse, në strukturat e policisë së qarkullimit rrugor, si dhe mjekë e ndihmësmjekë në strukturat e Policisë së Shtetit, përfitojnë shtesë për punë të vështira e të dëmshme për shëndetin, sipas përcaktimeve të bëra në vendimin përkatës të pagave të punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për rritjen e pagave për vitin 2011.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 15 korrik 2011.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha